

THIRRJE PËR APLIKIM

Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë;

Pagesa Direkte për therret e raportuara të gjedhit dhe grumbullimin (tërheqjen dhe pranimin) dhe përpunimin e nënprodukteve shtazore-mbetjeve;

Pagesa Direkte për viçat për majmëri;

Pagesa Direkte për akuakulturë;

Pagesa Direkte për zogj për majmëri (brojlerët);

Pagesa Direkte - Subvencionimi për sasi-kg të grurit të dorëzuar,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural /Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë do të vazhdoj të mbështesë sektorin e blegtorisë, sipërfaqes dhe rendimentit përmes pagesave direkte për qumësht/litër, therret e raportuara të gjedhit dhe grumbullimin (tërheqjen dhe pranimin) dhe përpunimin e nënprodukteve shtazore-mbetjeve, viçat për majmëri, zogjtë për majmëri (brojlerët), akuakulturë dhe sasinë e dorëzuar të grurit ashtu siq parashihet me programin e Pagesave Direkte 2025.

Periudha e aplikimit:

Afati i aplikimit fillon nga data 01.08.2025 dhe mbaron me datë 01.09.2025 ora 16:00

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT PËR QUMËSHT SIPAS KATEGORIVE TË CILËSISË:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar;
- Të kenë kontratë të lidhur për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar;
- Të dorëzojnë së paku 3000 litra qumësht për 6 (gjashtë) muaj (sipas gjashtëmujorëve të vitit kalendarik);
- Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështorë ose pikën e grumbullimit të qumështit e cila është e regjistruar si biznes dhe ka kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për persona juridikë);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridikë);
- Konfirmimi nga banka për xhirlogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridikë);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridikë);
- Kopja e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhet, dhentë dhe dhitë, të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I & R) në kuadër të AUV;
- Kopja e kontratës për furnizim me qumësht, e lidhur me qumështoret e licencuara në Kosovë ose me pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar;
- Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështorë ose në pikën e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznes dhe e cila ka kontratë me ndonjërin qumështorë të licencuar;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të pikës grumbulluese dhe kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, të pikës grumbulluese me ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të shitur (dorëzuar);

- Dëshmia e lëshuar nga laboratori i AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën e grumbullimit të qumështit e cila është e regjistruar si biznes dhe ka kontratë me ndonjërin qumështore të licencuar;
- Dëshmia për pjesëmarrjen në projektin “Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit” (e lëshuar nga Projekti “Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit”).

Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar, sipas kategorive:

1. Ekstra klasë = 0.07 €/litër
2. Klasa e Parë = 0.04 €/litër
3. Klasa e Dytë = 0.02 €/litër

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË APLIKUESIT PËR THERTORET:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të licencuara/aprovuara me vendim nga AUV për kategoritë të sigurisë A, B, C dhe D;
- Të raportojnë therjet në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit në AUV, sipas dinamikës së paraparë të thertores;
- Trupi i therur i kafshës/gjedhit duhet të kontrollohet dhe dëshmohet me vërtetim nga veterineri përgjegjës i autorizuar nga AUV;
- Gjodhet duhet të jenë të matriculuara me matriculë të Republikës së Kosovës.

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË APLIKUESIT / KOMPANIT - OPERATORET EKONOMIK TË CILAT BËJN GRUMBULLIMIN DHE PËRPUNIMIN E NËNPRODUKTEVE SHTAZORE-MBETJEVE:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të aprovuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit (tërheqjes, pranimit) dhe përpunimit të nënprodukteve shtazore – mbetjeve;
- Të bëjnë grumbullimin e nënprodukteve shtazore nga thertoret të cilat duhet të jenë të licencuara/aprovuara me vendim nga AUV për kategoritë të sigurisë A, B, C, D, si dhe nga mishtoret dhe fabrikat e përpunimit të mishit, të cilët gjenerojnë (krijojnë) nënprodukte shtazore – mbetje, si rezultat i procesit të pas therjes dhe përpunimit të mishit;
- Kafshët të cilat theren dhe nga të cilat gjenerohen (krijohen) nënproduktet shtazore, duhet të jenë të raportuara në regjistrin e therjeve, në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit në AUV, sipas dinamikës së paraparë;
- Të ketë kontrata të lidhura me kompanitë-operatorët ekonomik (thertoret, mishtoret dhe fabrikat e përpunimit të mishit) të cilët gjenerojnë (krijojnë) nënprodukte shtazore – mbetje, si rezultat i procesit të pas therjes dhe përpunimit të mishit;
- Kompanitë, në çdo kohë kur kërkohet nga AUV, duhet të kryejnë pa asnjë kompensim këto shërbimet: grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e kafshëve me sëmundje infektive apo të dyshimta me sëmundje të Brucellozes, Tuberkulozit TBC, leukozes (sëmundje virale), sëmundje biologjike Plasja (Anthrax), sëmundje të cilat konsiderohen zoonotike;
- Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të grumbulluara (tërhequra, pranuar) të nënprodukteve shtazore prej kompanive-operatorëve ekonomik (thertoreve, mishtorëve dhe fabrikave të përpunimit të mishit) në Kosovë, me të cilat kanë kontratë të lidhur.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM PËR THERTORET:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për persona juridikë);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridikë);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridikë);
- Kopja e lehtënjofimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridikë);
- Kopja e regjistrimit të kafshëve të kafshëve të therura, i lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit - AUV, të dëshmuar me pasaportën e kafshës së therur;

- Vërtetimi-dëshmia e lëshuar nga veterineri përgjegjës i autorizuar nga AUV për realizimin e kontrollit të trupit të therur të kafshës/gjedhit;

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM PËR KOMPANIT - OPERATORET EKONOMIK TË CILAT BËJN GRUMBULLIMIN DHE PËRPUNIMIN E NËNPRODUKTEVE SHTAZORE-MBETJEVE:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK;
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit ;
- Kopja e regjistrimit të kafshëve të therura, i lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit - AUV;
- Kopja e kontratës të lidhura me kompanitë-operatorët ekonomik (thertoret, mishtoret dhe fabrikat e përpunimit të mishit) për tërheqjen, pranimin dhe grumbullimin e nënprodukteve shtazore – mbetje të gjeneruara (krijuara), si rezultat i procesit të pas therjes dhe përpunimit të mishit;
- Dëshmia për sasinë mujore të tërhequra, pranuar dhe grumbulluara të nënprodukteve shtazore, prej kompanive-operatorëve ekonomik (thertoreve, mishtorëve dhe fabrikave të përpunimit të mishit) në Kosovë.

MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi bëhet për krerë gjedhi të therur të raportuar dhe për kilogram të nënprodukteve shtazore të tërhequra, pranuar dhe grumbulluara:
 - Subvencionimi për krerë gjedhi të therur të raportuar, në vlerë prej 50 €/krerë, u bëhet thertoreve përfituese;
 - Subvencionimi për nënproduktet shtazore të tërhequra, pranuar dhe grumbulluara, në vlerë prej 0.16 €/kg, u bëhet kompanive/operatorëve ekonomik, të cilët realizojnë grumbullimin (tërheqjen, pranimin) dhe përpunimin e nënprodukteve shtazore-mbetjeve.

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT PËR AKUAKULTURË:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të shesin së paku 2500 kg peshk të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temperaturë +5°C i paketuar në vakum) brenda gjashtë (6) muajve, në Republikën e Kosovës ose jashtë vendit (eksport);
- Llojet e pranueshme të peshkut për subvencionim janë: Trofta dhe Krapa;
- Të jenë të licencuar nga MBPZHR për zhvillimin e aktiviteteve në akuakulturë;
- Të jenë të regjistruar në AUV.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM;

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për persona juridikë);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridikë);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridikë);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridikë);
- Dëshmi për sasinë dhe vendin e origjinës së ushqimit për peshk;
- Dëshmi nga ATK, për sasinë e shitur të peshkut të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temp +5°C i paketuar në vakum).

MËNYRA E SUBVENCONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për kg të peshkut të shitur, në vlerë prej 0.30 €/kg;
- Do të mbështeten (subvencionohen) të gjithë fermat - pronarët e hurdhave të peshkut që shesin së paku 2500 kg/peshk të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temp +5°C i paketuar në vakum) brenda gjashtë muajve, në Republikën e Kosovës ose jashtë vendit (eksport).

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT PËR VIÇAT PËR MAJMËRI:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

- Të mbarështojnë së paku 10 krerë viça për majmëri (meshkuj dhe femra) gjatë vitit kalendarik;
- Në kohën/ditën e aplikimit, moshë e viçave për majmëri duhet me qen nga 6 - 14 muaj;
- Viçat për majmëri duhet të jenë të matrikuluara me matrikulë të Republikës së Kosovës;
- Viçat për majmëri duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;

Numri i viçave për majmëri në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për persona juridikë);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Regjistri për vitin 2024, i lëshuar nga Praktikat veterinare të kontraktura ose të autorizuar nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur në të gjitha fletët/faqet;

MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për krerë -viça për majmëri, në vlerë prej 25 €/krerë;
- Përfitues do të jenë fermerët/subjektet të cilët mbarështojnë së paku 10 krerë të viçave për majmëri, gjatë viti kalendarik, dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT PËR ZOGJË PËR MAJMËRI (BROJLERËT):

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarështojnë së paku 2000 zogj për majmëri (brojlerë) gjatë viti kalendarik;
- Subjekti duhet të jetë i regjistruar në AUV;
- Subjekti duhet të dëshmojë se shitja zogjve për majmëri (brojlerë) është realizuar në formë të rregullt, me faturë dhe/ose kuponë fiskal të shitjes.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit - ARBK (vetëm për persona juridikë);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit / pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e dëshmisë për numrin dhe origjinën e zogjve një ditor, fatura e furnizimit/blerjes nga importuesi apo prodhuesi, në të cilën duhet të saktësohet se zogjtë janë për majmëri;
- Fatura e furnizimit/blerjes për zogjtë një ditor për majmëri, janë të pranueshme vetëm për furnizimet e realizuara gjatë viti kalendarik 01.01 – 31.12.2025;
- Dëshmia/fatura dhe/ose kuponi fiskal e shitjes, me të cilën dëshmohet se shitja e zogjve për majmëri (brojlerëve) është bërë në formë të rregullt.

MËNYRA E SUBVENCIONIMIT:

- Subvencionimi do të bëhet për njësi zog për majmëri (brojlerë), të shitur dhe të dëshmuar me faturë dhe/ose kupon fiskal të shitjes, në vlerë prej 0.20 €/zog.

- Përfitues do të jenë fermerët/subjektet të cilët mbarështojnë së paku 2000 zogj për majmëri (brojlerë) gjatë viti kalendarik dhe që i plotësojnë kriteret e parashtruara sipas këtij programi.

Gjithashtu gjatë kësaj thirrje për aplikim do të bëhet edhe subvencionimi shtesë tek kultura: grurit,

Subvencionimi për sasi-kg të grurit të dorëzuar;

Përfituesit të kësaj mbështetje shtesë nga subvencionimi bazë duhet të ofrojnë:

- Dëshmi për dorëzimin e sasisë së grurit në pikën grumbulluese: mulli, silos ose pikë të veçante grumbulluese të grurit. Në dëshminë e lëshuar nga pika grumbulluese përkatëse, për sasinë e grurit që fermeri ka dorëzuar, duhet të jetë i shënuar edhe numri identifikues i fermerit (NIF), si dhe dëshmia duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga ana e personit të autorizuar të pikës

grumbulluese. (Ky dokument duhet të sillet/dorëzohet mbas realizimit/përfundimit të procesit të korrje shirjes së grurit, nga datë 01.08. deri 01.09.2025);

- Subvencionimi për sasi-kg të grurit të dorëzuar, në vlerë prej 0.04 €/kg;